REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# KËSHILLI I MINISTRAVE
# KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

## V E N D I M

Nr.05, datë 06.11.2018

## PËR

## MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "RIKONSTRUKSION I PLOTË PËR ADOPTIM ZYRA, ISH REPARTI MARANGOZ E HIDRAULIK, APARATI QËNDROR I SHISH-IT", BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të Shërbimit Informativ të Shtetit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

## VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: "Rikonstruksion i plotë për adoptim zyra, ish reparti marangoz e hidraulik, Aparati Qëndror i SHISH-it, Bashkia Tiranë", me subjekt zhvillues Shërbimin Informativ të Shtetit.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Tiranë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**DAMIAN GJIKNURI**

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**